



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM  
Nr. 29, datë 14.05.2019

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË  
ZOTIT AVNI SHEHU, PËR SHKAK TË TËRHEQJES NGA KANDIDIMI PËR  
GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

<b>Ardian Dvorani</b>	- Kryetar
<b>Arta Marku</b>	- Anëtare/Relatore
<b>Fatri Islamaj</b>	- Anëtar
<b>Margarita Buhali</b>	- Anëtare
<b>Eriol Roshi</b>	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e Avokates së Popullit, **zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës 14.05.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDADI PËR GJYQTAR  
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**      **Zoti AVNI SHEHU**

**OBJEKTI:**      **Tërheqje nga kandidimi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për plotësimin e vendit vakant të shpallur në datën 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.**

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji relatimin e anëtares së Këshillit, **zonjës Arta Marku**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë*”, Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Sokol Berberi.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe zoti Avni Shehu.

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 229, 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “*Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion*”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Arta Marku.

7. Zoti Avni Shehu, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Avni Shehu, gjendet e administruar në dosjes e kandidimit.

8. Në datën 10.04.2019, kandidati Avni Shehu është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen kandidimit.

9. Në datën 12.04.2019, kandidati zoti Avni Shehu ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizime përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot., datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Avni Shehu, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës. Sipas kësaj Deklarate, rezulton se kandidati Avni Shehu është paraqitur pranë zyrës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe e ka nënshkruar atë në datën 10.04.2019.

12. Me shkresën nr.2854/3 prot., datë 26.04.2019 dhe me shkresën nr.2854/4 prot., datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Avni Shehu nuk e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë, pranë këtij institucioni. Sipas ILDKPKI afati 15 ditor për dorëzimin e plotësuar të Deklaratës së pasurisë ka qenë data 25.04.2019.

13. Në zbatim të pikës 26 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, në datën 03.05.2019, është njoftuar kandidati Avni Shehu mbi të drejtën e tij për të paraqitur, me shkrim, brenda datës 07.05.2019, drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me këtë gjetje të procedurës së verifikimit, si edhe dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij. Njëkohësisht, bashkë me njoftimin i janë dërguar për tu njohur edhe kopje elektronike të akteve të sipërcituara në këtë vendim.

14. Kandidati Avni Shehu, në datën 05.05.2019, ka konfirmuar në rrugë elektronike se ka marrë dijeni për njoftimin për paraqitjen e pretendimeve, si dhe ka depozituar në datë 06.05.2019 në zyrën e Këshillit shpjegimet e tij me shkrim lidhur me gjetjet e njoftuara të procedurës së verifikimit për sa i përket kontrollit të pasurisë.

15. Në thelb, në shpjegimet e tij, kandidati Avni Shehu, parashtron se:

- *Nga ana e ime nuk është refuzuar deklarimi i pasurisë dhe interesave private, por në ditën e fundit të afatit 15 ditor kam sqaruar pamundësinë time për të dorëzuar në afat deklarimin duke parashtruar edhe rrethanat objektive.*

- *Kam kërkuar zgjatjen e afatit për dorëzimin e deklarimit në mënyrë që të paraqisja atë të plotë dhe të saktë, duke patur parasysh përgjegjësinë që sjell pavërtetësia e deklarimeve të tilla.*

- *Për arsye se është hera e parë që bëjë deklarim dhe se gjithë veprimtaria ime dhe e personave të lidhur është në sektorin privat për më shumë se 20 vjet, mbledhja e dokumentacionit të saktë për burimin e të ardhurave për një afatë 15 ditor ka qenë objektivisht i pamundur.*

- *Kërkoj caktimin e një afati të ri, jo më pak se 1 muaj për dorëzimin e formularit të deklarimit të pasurive dhe interesave private pranë ILDKPKI dhe nëse nuk çmohet i arsyeshëm atëherë heq dorë nga kandidimet e paraqitura nga ana ime.*

16. Në zbatim të pikës 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, anëtari i Këshillit relator për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, ka njoftuar Këshillin lidhur me vullnetin e shprehur nga kandidati Avni Shehu për tërheqjen nga kandidimi për këtë vend vakant, duke përgatitur dhe dërguar për shqyrtim relacionin dhe projektaktin përkatës mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të këtij kandidati.

17. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 14.05.2019, rendin e ditës, si edhe duke bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zotit Avni Shehu, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

18. I njëjti njoftim, së bashku me materialet e çështjes i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

19. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 14.05.2019 dhe rendin e ditës janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

20. Njëkohësisht, për shqyrtimin në këtë mbledhje të çështjes lidhur me përfundimin e procedurës, lejimin ose ndalimin e kandidimit për sa i përket kushteve dhe kriterëve të integritetit pasuror, është njoftuar edhe kandidati Avni Shehu.

21. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

22. Në thelb, Avokati i Popullit parashtrori nuk vëren parregullsi në procedurat e ndjekura deri më tani për verifikim e kandidaturës. Lidhur me qëndrimin e kandidatit për kohën e shkurtër për plotësimin e deklaratës dhe kërkesën drejtuar Këshillit për ti caktuar afat të ri një mujor për plotësimin e saj në ILDKPKI, të mbahet parasysh se pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 ka përcaktuar shprehimisht detyrimin e kandidatëve që Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë ta dorëzojnë të plotësuar pranë ILDKPKI *“jo më vonë se 15 ditë nga marrja pranë Këshillit të formularëve për deklarimin e pasurisë”*. Ligji nuk i njeh as ILDKPKI dhe as Këshillit kompetenca për të zgatur afatin 15 ditor. Vullneti alternativ i kandidatit për tërheqje nga kandidimet nëse nuk ka vend për shtytje afatesh për deklarimin e pasurisë është i qartë dhe i shprehur rregullisht.

## **II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

23. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga anëtari i Këshillit relator i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, si edhe në vetë formën alternative të shprehjes së vullnetit nga kandidati në shqyrtim lidhur me kandidaturat e tij, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit Avni Shehu.

24. Në pikën 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese, Presidenti i Republikës:

*“1. .... shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7/a paraqiten pranë Presidentit të Republikës, i cili ia dërgon ato Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.”*

25. Në zbatim të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 234 e vijues të Ligjit nr. 115/2016, pas dërgimit të listës së kandidatëve që kanë shprehur interes së bashku me dokumentacionin e paraqitur, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar në datën 05.04.2019 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kritereve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

26. Ligji nr. 8577/2000 dhe Ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në raste të tilla.

27. Por, nga ana tjetër, Ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se :

*“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”*

28. Bazuar në këtë detyrim dhe delegim ligjor për të miratuar, në bazë dhe për zbatim të ligjit, rregulla më të detajuara normative, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë aktin nënligjor normativ, vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

29. Në lidhje me rastin e tërheqjes nga kandidimi, në vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në pikat 8 dhe 31 të tij, parashikohet se :

*“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.”.*

*“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.”.*

30. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore normative të zbatueshme në rastin e tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidatit Avni Shehu. Kandidati është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, sipas rrugës elektronike në datë 05.04.2019.

31. Gjithashtu, nga aktet që përmban dosja e kandidimit, rezulton që kandidati Avni Shehu, në datën 06.05.2019, ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi një shkresë, me anë të së cilës, njofton Këshillin dhe parashtron në thelb se:

*- Nga ana e ime nuk është refuzuar deklarimi i pasurisë dhe interesave private, por në ditën e fundit të afatit 15 ditor kam sqaruar pamundësinë time për të dorëzuar në afat deklarimin duke parashtruar edhe rrethanat objektive.*

*- Kam kërkuar zgjatjen e afatit për dorëzimin e deklarimit në mënyrë që të paraqisja atë të plotë dhe të saktë, duke patur parasysh përgjegjësinë që sjell pavërtetësia e deklarimeve të tilla.*

*- Për arsye se është hera e parë që bëjë deklarim dhe se gjithë veprimtaria ime dhe e personave të lidhur është në sektorin privat për më shumë së 20 vjet, mbledhja e dokumentacionit të saktë për burimin e të ardhurave për një afatë 15 ditor ka qenë objektivisht i pamundur.*

*- Kërkoj caktimin e një afati të ri, jo më pak se 1 muaj për dorëzimin e formularit të deklarimit të pasurive dhe interesave private pranë ILDKPKI dhe nëse nuk çmohet i arsyeshëm atëherë heq dorë nga kandidimet e paraqitura nga ana ime.*

32. Në lidhje me shpjegimet dhe kërkimet alternative të sipërcituara të kandidatit Avni Shehu, Këshilli vlerëson të evidentojë se, në pikën 2 të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, parashikohet qartë se:

*“2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave..... ”*

33. Kjo dispozitë dhe ligji nr. 115/2016 në tërësi nuk parashikon raste përjashtimore dhe as edhe mundësi për zgjatje afati përtej atij 15 ditor, as edhe nuk i jep ILDKPKI ndonjë kompetencë për të vlerësuar zgjatje apo pranim të Deklaratës përtej këtij afati ligjor.

Gjithashtu, kjo dispozitë dhe ligji nr. 115/2016 në tërësi nuk i caktojnë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kompetenca që të ndërhyjë në ushtrimin e kompetencave të organeve të tjera të ngarkuara me detyrime kontrolli e verifikimi, sikurse është edhe ILDKPKI, sikurse edhe që të vlerësojë dhe urdhërojë këto organe të pranojnë kryerjen e veprimeve kontrolluese përtej afateve që i cakton vetë ligji.

34. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vetëm kompetencën që, për pjesën e veprimeve të procedurës së verifikimit që kryhen dhe administrohen nga vetë Këshilli, të vlerësojë rast pas rasti, në varësi të motive që parashtron kandidati, për ti dhënë ose jo afate të reja për plotësimin e detyrimeve që caktohen nga ligji ose aktet normative të Këshillit, sikurse është edhe vendimi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

35. Duke pasur parasysh sa arsyetohet më sipër për ligjin e zbatueshëm dhe interpretimin e tij, si edhe parashtrimin alternativ të shpjegimeve të kandidatit Avni Shehu, Këshilli vlerëson të rregullt në aspektin e qartësisë së vullnetit të shprehur nga ky kandidat në shkresën e sipërcituar drejtuar Këshillit, për tërheqjen nga kandidimi në rast se Këshilli nuk do të vlerësonte të jepte një mundësi për shtyrje afati për Deklarimin e Pasurisë pranë ILDKPKI.

36. Sikurse arsyetohet më sipër në këtë Vendim, Këshilli nuk e ka kompetencën të shtyjë a caktojë afat të ri, përtej atij 15 ditor të caktuar shprehimisht nga ligji, që kandidatët të paraqesin dhe depozitojnë Deklaratën së Pasurisë pranë ILDKPKI. Prandaj, ky Këshill mban parasysh vullnetin e qartë të shprehur nga kandidati për tërheqjen nga kandidimi në rast se nuk gjendet mundësi për ti dhënë një afat të ri për plotësimin dhe dorëzimin e kësaj Deklarate në ILDKPKI.

37. Këshilli vlerëson që shprehja e interesit dhe kandidimi për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

38. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedimit, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet në Gjykatën Kushtetuese, atëherë nuk ka më vend të vijojnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 dhe 3 të nenit 229 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të pikave 8 dhe 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

## **VENDOSI:**

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zotit Avni Shehu, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Avni Shehu.
3. Kandidatit Avni Shehu ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**

**Ardian DVORANI**

